

LIGJ
Nr.8210, datë 23.4.1997

**PËR PËRJASHTIMIN NGA TAKSAT DHE TATIMET TË NDIHMAVE HUMANITARE
DHE TË EMERGJENCËS**

Në mbështetje të nenit 16 të ligjit nr.7491, datë 29.4.1991 "Për dispozitat kryesore kushtetuese" me propozimin e Këshillit të Ministrave

KUVENDI POPULLOR
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

Neni 1

Për periudhën e stabilizimit të rendit e të qetësisë të përjashtohen nga taksat doganore dhe të konsiderohen furnizime të përjashtuara nga pagimi i tatimit të vlerës së shtuar:

1. Ndihamat humanitare ushqimore që jepen falas nga individë a grupe individësh, shoqata, shtete dhe organizata qeveritare ose joqeveritare, kombëtare ose ndërkombëtare, dhe kur përfituesit e tyre janë organet e shtetit shqiptar, Kryqi i Kuq Shqiptar ose organizata shqiptare jofitimprurëse, dhe nuk do të shiten në treg.

2. Ndihamat në pajisje mjekësore e medikamente që jepen falas nga individë a grupe individësh, shoqata, shtete dhe organizata qeveritare ose joqeveritare, kombëtare ose ndërkombëtare, në rastet kur përfituesit e tyre janë organet e shtetit shqiptar ose institucione shtetërore shëndetësore, dhe nuk do të shiten në treg.

3. Ndihamat në materiale e pajisje që jepen falas nga individë a grupe individësh, shoqata, shtete dhe organizata qeveritare ose joqeveritare, kombëtare ose ndërkombëtare, kur përfitues janë organet shtetërore ose institucionet shtetërore buxhetore, organizata a shoqata shqiptare jofitimprurëse dhe që do të përdoren me destinacion rivënien në funksionim të tyre.

Neni 2

Ndihamat humanitare dhe të emergjencës që do të jepen falas nga individë a grupe individësh, shoqata, shtete dhe organizata qeveritare dhe joqeveritare, kombëtare ose ndërkombëtare, kur përfitues janë organet shtetërore dhe që do të shiten, i nënshtrohen pagimit të taksave doganore dhe tatimit të vlerës së shtuar. Derdhja e taksave doganore dhe e tatimit të vlerës së shtuar do të bëhet në kohën e shitjes së parë me shumicë të këtyre ndihmave. Mënyra e pagimit të detyrimeve të parashikuara në këtë nen do të përcaktohet nga Këshilli i Ministrave në vendimin që ai do të nxjerrë për zbatimin e këtij ligji.

Nuk i nënshtrohen pagimit të detyrimeve të parashikuara në paragrafin e parë të këtij neni ato mallra, të cilat me dispozita të veçanta ligjore janë të përjashtuara nga pagimi i taksës doganore dhe tatimit të vlerës së shtuar.

Neni 3

Si bazë llogaritjeje për taksat doganore për mallrat e parashikuara në nenin 2 të këtij ligji do të shërbejnë vlerat minimale doganore të caktuara me vendim të Këshillit të Ministrave, pavarësisht nga vlera e faturuar e tyre. Për mallrat që nuk janë të përfshira në listën e vlerave minimale, për llogaritjen e çmimeve do të merret për bazë vlera e mallit në faturë.

Neni 4

Këshilli i Ministrave të nxjerrë aktet e nevojshme në zbatim të këtij ligji.

Neni 5

Çdo dispozitë ligjore që bie në kundërshtim me këtë ligj nuk zbatohet për aq kohë sa ky ligj do të jetë në fuqi sipas nenit 6 të tij.

Neni 6

Ky ligj hyn në fuqi më datën 23.4.1997 dhe i shtrin efektet e tij deri më 31.12.1997.

Shpallur me dekretin nr.1783, datë 25.4.1997 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Sali Berisha